

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA E KOSOVËS
MINISTRIA E DREJTËSISË - MINISTARSTVO PRAVDE - MINISTRY OF JUSTICE

SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS - KOREKCIJNA SLUŽBA KOSOVA
KOSOVO ELECTORAL SERVICE

Nr./No./No. Org./Org./Org. Unit: _____
01 No./No./No. 2033 Data/Date/Date: 09/12/09
Shtojca/Dodaci/Annex: _____
PRISHTINË/A



REPUBLIKA E KOSOVËS, REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA E KOSOVËS
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br./No: 01-1670
Data/ Datum/Date: 01/12/09
Shtojca/Dodaci/Annex: _____
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Ministria e Drejtësisë/Shërbimi/Korrektues i Kosovës, bazuar në Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 30,31,32, Udhëzimin Administrativ nr. 01/2007 për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, me qëllim të përcaktimit të rregullave për sigurinë në Institucione Korrektuese me rastin e pranimit dhe vendosjes së të burgosurve në Institucionet Korrektuese nxjerrë

**UDHËZIM ADMINISTRATIV
PËR PRANIMIN DHE VENDOSJEN E PËRSONAVE TË BURGOSUR
(DËNUAR) NË INSTITUCIONET KORREKTUESE**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1.
Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ përcakton kushtet dhe procedurat e pranimit dhe vendosja e personave te burgosur(dënuar) ne Institucionet Korrektuese

Drejtori i Burgut duhet ti caktoj punëtorët për pranimin e te burgosurve. Kur te pranohet i burgosuri duhet te vërtetohet identiteti i tij/saj, te vërtetohet dokumenti valit nga gjykata (aktgjykimi apo aktvendimi).

Neni 2

Procedura e pranimi

1. Gjatë pranimi ne burg ,duhet te ndërmerren këto veprime:
 - a. Pranimi dhe kontrollimi i dokumentacionit personal dhe gjyqësor i te burgosurit
 - b. Dita dhe ora e pranimi dhe lirimit
 - c. Informacione lidhur me identitetin e te Burgosurit
 - d. Te burgosurit pa dokumentacion Zyrtar te Identifikimit ,Kërkohe nga policia qe te njëjtin ta fotografojnë dhe te garantojnë me nënshkrim se personi ne fjalë i përgjigjet dokumentit gjyqësor.
 - e. Pranim-dorëzimi i te burgosurit dhe gjësendeve te tij nga ana e policisë dhe stafit te caktuar për pranim.
 - f. Regjistrimi i te burgosurve ne librin e pranimi (emri dhe mbiemri,datëlindja ,vendlindja ,vepra,kohëzgjatja e dënimit
 - g. Kontrollim(bastisja)me zhveshje e te burgosurit kryhet nga ana e dy oficerëve te gjinisë te njëjt me te burgosurin dhe plotësohet raporti përkatës për bastisje.
 - j. Kontrollimi dhe regjistrimi i gjerave personale ne formular përkatës ne prezence te burgosurit dhe nënshkruar nga oficeri dhe i burgosuri
 - h. Pranimi i parave nga i burgosuri regjistrohen ne formularin përkatës dhe nënshkruhen nga i burgosuri ne tri kopje : një tek i burgosuri,një ne zyrën e financave ,një ne depozitë,parat e pranuar nga stafi dorëzohen ne zyrën e financave te burgosurve .
 - h. Gjësendet dhe sendet me vlerë te lejuara i dorëzohen te burgosurit bashkë me formularin,ndërsa gjerat e pa lejuara do te mbesin ne depozitë.
 - i. Fotografimi i te burgosurit përfshirë edhe fotografimin e shenjave dhe tatuazheve dhe vendosja e tyre ne dosje (pakon e arratisjes).

k. organizimi dhe pranimi duhet të jetë në përputhje me parimin themelor të rregullave dhe të ndihmoj të burgosurin për të zgjedhur problemet e tyre urgjente personale.

1. raportet dhe informacionet lidhur me të burgosurin do të ruhen duke pasur parasysh karakterin konfidencial mbi të dhënat individuale, do të plotësohen rregullisht në kohë dhe të njëjtat mund të shihen vetëm nga personat e autorizuar

2. Furnizimi i të burgosurit me gjësende të nevojshme, pranimin e të cilave e vërteton me nënshkrim në formular të posaçëm.

Neni 3

- Personat e burgosur meshkuj dhe femra vendosen ndarazi .
- Grat shtatzëna ,dhe nenat që kujdesen për fëmijët e tyre duhen të akomodohen ndaras nga grat tjera të burgosura-dënuara.
- Te miturit nuk vendosen në Institucion Korrektues ose në një pjesë të Institucionit me personat madhor.
- Personat e dënuar nuk duhen të vendosen në pavijonin e njëjt me të paraburgosur
- Duhet të bëjë përpjekje që personat e dënuar për herë të parë të ndahen nga recidivistët.

Neni 4

Gjatë vendosjes së personave të dënuar në institucione duhet të merren parasysh:

- Moshë e tij/ saj
- Lartësia e dënimit
- Shëndeti i tij/ saj fizik dhe mendor
- Rekomandimi prej autoriteteve relevante për trajtim të veçantë

Neni 5

Intervista me të Burgosur

Te gjithë të burgosurit duhet të intervistohen nga zyrtarët social brenda javës së parë të pranimi për të qartësuar ndonjë qeshje urgjente.

Brenda 24 orëve i burgosuri duhet të shkojë te mjeku (të vizitohet nga mjeku) për të kryer kontrollin mjekësor dhe vendosja e te burgosurit në tretman pranimit. Posa të pranohet i burgosuri duhet të ofrohet mundësia të kontaktoj me familjen. Shtetasit të huaj duhet të ofrohet mundësia të kontaktoj me ambasadën apo zyrën ndërlidhëse të shteti që i përket. Të njoftohet i burgosuri me rendin shtëpiak dhe rregullat e burgut dhe procedurat e ndryshme brenda javës së pranimit.

Neni 6

Pakoja e arratisjes

6.1 Pakoja e arratisjes (Dosja kumulative) duhet të përgaditet për çdo të burgosur gjatë pranimit. Kjo pako duhet të ketë këto informata:

- a. Dhjetë fotografi të te burgosurit, profil, i majte dhe i djathtë (të fytyrës pa kapele)
- b. Profili i te burgosurit (emri dhe mbiemri, mosha, vepra penale, kohëzgjatja e dënimit, data e fillimit të dënimit si dhe data e përfundimit të dënimit)
- c. Përshkrimi fizik i te burgosurit (Gjatësia, pesha ngjyra e syve dhe flokëve)
- d. Adresa e vendbanimit / vendqëndrimin (nëse është e mundur).

6.2 Pakoja e arratisjes duhet të mbahet në një vend të gatshëm për qasje nga stafi menagjues i institucionit

Neni 7

- Fotografit e te burgosurit duhet të ndërrohen çdo tri (3) vite apo me herët po qese ka ndryshime të mëdha të pamjes fizike të tij / saj.
- Duhet të përgatitet kartela identifikues për secilin të burgosur me të pranuar në institucion.
- Kartelat identifikues duhet të dallohen varësisht nga statusi i te burgosurit, si i dënuar i paraburgosur dhe i mitur.
- Kartela i identifikuese e te burgosurit duhet ta shoqëroj te burgosurin kur ai/ajo lëshon pavijonin përkatës apo përcillet në ndonjë pjesë tjetër të institucionit.

- Te burgosurve nuk u lejohej ta posedoj kartelën identifikuese.
- Nëse i burgosuri transferohet, kartela identifikuese duhet të vendoset në dosje kështu që mund të përdoret në institucionin tjetër- qendër të paraburgimit.

Neni 8

Ky Udhëzim administrativ hynë në ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë: 25.11.2009

Ministria e Drejtësisë
Nekibe Kelmendi
Nekibe Kelmendi
Ministre

